



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe me propozim të shtabit komunal për mbrojtje nga COVID-19 nga mbledhja e mbajtur më 13.03.2020, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

U R D H Ë R E S Ë

1. Me qëllim të ndërmarrjes së masave preventive për mbrojtje nga përhapja e coronavirusit në Komunën e Vushtrrisë urdhëroj që të merren masa dhe aktivitete si në vijim:
 - 1.1 Të bëhet dezinfektimi i të gjitha objekteve publike – shkollave në qytet dhe të gjitha fshatrat, QKMF-së QMF-ve dhe pikave ambulatore në territorin e komunës,
 - 1.2 Të bëhet mbyllja e tregjeve, tregu i shitësve ambulant në qendër të qytetit duke përfshi edhe tregun e bagëtive
 - 1.3 Të punësuarit në administratën e komunës nuk do të vijojnë në punë nëse të dy bashkëshortët janë të punësuar
 - 1.4 Shërbyesit civil që janë me sëmundje kronike lirohen nga ardhja në punë deri në një vendim tjetër
 - 1.5 Të ardhurit në komunën e Vushtrrisë, nga Italia, Gjermania dhe shtetet me përfshirje të lartë nga koronavirusi të vet izolohen për të iu shmangur rrezikut të përhapjes së kësaj sëmundje.
 - 1.6 Secili qytetar i komunës së Vushtrrisë i cili dyshon se mund të jetë i infektuar me koronavirus, të lajmërohen në nr. tel. 038/20080800.
 - 1.7 Edhe përkundër faktit se në Komunën e Vushtrrisë nuk ka asnjë rast të infektimit me koronavirus, të përcillet me vëmendje të shtuar situata e përgjithshme rreth përhapjes së kësaj sëmundje dhe të sillemi me përgjegjësi të plotë në mënyrë që të tejkalohet me sa më pak kjo gjendje në të cilën ndodhemi.
 - 1.8 Drejtoria për inspektimi të merr masa të duhura në terren konform konform kompetencave dhe përgjegjësi të përcaktuara me akte ligjore në fuqi.
2. Shtabi komunal për mbrojtje nga koronavirusi të përcjell me vigjilencë gjendjen në terren dhe ndërmerr masa adekuate në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.
3. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe duhet të zbatohet menjëherë.



Xhafer Tahiri

Kryetari i komunës